



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:057442

Datë: 01.09.2024

Numri i dokumentit: 06228815

KA.nr.400/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, KA.nr.400/22
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për
Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Lab-
Oil” ShPK me NUI 810800153 dhe seli në magjistralen Prishtinë-Shkup në Graçanicë, i cili
përfaqësohet në bazë të prokurës nga avokati Gafurr Elshani me seli në rrugën Nënë Tereza nr.
34 në Prishtinë, kundër të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me seli në Prishtinë,
objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës
14.05.2024 në të cilën morën pjesë të dy palët, më 1 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Lab-Oil” ShPK me NUI 810800153 kundër të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe anulohen në tërësi pikat I., II., IV., dhe V. të vendimit nr. 37/2020 të datës 06.05.2020 të komisionit të së paditurit.
- II. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin administrativ të anuluar si në pikën I. të këtij dispozitivi.
- III. Hedhet poshtë padia e paditësi Lab-Oil” ShPK me NUI 810800153 kundër të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, në pjesën që ka kërkuar anulimin e njoftimit mbi konstatimin e gjendjes faktike nr. 40/20 të datës 31.01.2020 të së paditurit, si dhe në pjesën me të cilën ka kërkuar anulimin edhe të pikës III., të vendimit nr. 37/2020 të datës 06.05.2020 të komisionit të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 21.05.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit me kërkesë për anulimin e njoftimit mbi konstatimin e gjendjes faktike nr.

40/20 të datës 31.01.2020 të së Paditurit, si dhe anulimin e tërësishëm të vendimit nr. 37/2020 të datës 06.05.2020 të komisionit të së Paditurit.

2. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, i Padituri në kohën kur ishte dhënë vendimi i goditur dhe është parashtruar padia, në bazë të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i ndryshuar përmes Ligjit nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (këtu e tutje LMK) quhej Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ndërsa në tani sipas nenit 3 para. 4 të Ligji nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës quhet Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës. Duke qenë se në vendimin e goditur përdoret emërtimi i vjetër i të Paditurit dhe me qëllim të identifikimit më të lehtë të aktit administrativ, gjykata vendosi ta përdor emërtimin e të Paditurit, që e kishte në ditën e dhënies së vendimit të goditur.
3. Paditësi në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se, vendimi i goditur përmban një tekst të gjatë që mbështetet në parafrazime dhe përshkrimi nga librat shkollorë dhe universitar, i parafrazon dispozitat ligjore, por nuk ka argumente konkrete me të cilat do të arsyetonte kundërshtimin në padi dhe vendimet të Paditurit. Sipas tij, pretendimet e paraqitura në konstatimin e gjendjes faktike nr.40/20 të datës 31.01.2020 dhe në vendimin nr.37/20 të datës 06.05.2020, nga ana i Padituri janë vetëm supozime të pabazuara në ligj dhe të pavërtetuara në prova. Më tutje ka shtuar se, komisioni i të Paditurit nuk ka specifikuar se cila ka qenë konkretisht marrëveshja e arritur apo praktikat e bashkërenduara nenin 4 para.1, përmes të cilave është caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çmimet e blerjes apo shitjes apo çdo kush tjetër tregtimi nga Paditësi dhe me cilat subjekte ekonomike konkretisht i ka bërë këto marrëveshje apo këto praktika të bashkërenditura.
4. Paditësi gjithashtu ka pretenduar se, me rastin e marrjes së vendimit me të cilat shqiptohet masa ndëshkuese administrative në shumat të larta si në pikën 2 të dispozitivit nuk mjaftojnë vetëm të bëhen shpjegime teorike i përkufizimit nga neni 3 dhe 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, por duhet që çdo pretendim të vërtetohet edhe me provat konkrete. Në këtë drejtim ka deklaruar se, komisioni i të Paditurit nuk ka shpjeguar se cili është kufiri në mes të konstatimit se në ekonominë e tregu çmimi përcaktohet nga ekonomia e lirë dhe vendoset në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja dhe vlerësimi të tyre të Paditurit se ai ka caktuar çmimin e shitjes dhe mazhën e fitimit bruto për muajt nëntor dhe dhjetor në mënyrë të bashkërenduar me kompanitë tjera, të cilat operojnë në tregun relevant në shitje me pakicë.

5. I Padituri me përgjigjen në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ai në përgjigje në padi ka deklaruar se veprimtaria e kompanive shpërndarëse të derivateve të naftës, shpesh në mënyrë direkte apo tërthorazi të heshtur, bie ndesh me rregullat e konkurrencës, në rastin konkret duhet të njoftohemi me këto dy terma të mëposhtëm të cilat shpjegojnë efektin shkak-pasojë. Sipas tij, praktikë e bashkërenduar është një bashkërendim midis ndërmarrjeve, të cilat pa arritur fazën e nënshkrimit të një marrëveshjeje zyrtare, me dijeni, kryejnë bashkëpunim praktik për të shmangur rrezikun e konkurrencës. Në këtë drejtim ka sqaruar se, një praktikë e bashkërenduar mund të realizohet me kontakte të drejtpërdrejta ose të tërthorta midis firmave, synimi apo rezultati i të cilave është që të ndikohet sjellja e tregut ose tu jepet informacion konkurrentëve në lidhje me veprimet e ardhshme. Ndërsa, oligopolin e ka përkufizuar si strukturë tregu në të cilën ka shumë pak shitës, të cilët e realizojnë ndërvarësinë e tyre, duke marrë vendime strategjike që mund të kenë lidhje me çmimet, vëllimin e prodhimit ose cilësinë. Në lidhje me këtë ka sqaruar se, në një situatë oligopoli, të gjitha firmat e dinë që sjellja e tij në treg do të prekë edhe shitësit e tjerë dhe sjelljen e tyre në treg, rrjedhimisht të gjitha firmat i kanë parasysh reagimet e mundshme të lojtarëve të tjerë. Sipas tij, në rastet e konkurrencës, ky term përdoret shpesh për ato situata në të cilat një numër i vogël shitësish të mëdhenj dominojnë në mënyrë të përbashkët strukturën e konkurrencës dhe një bashkësi shitësish të vegjël i përshtaten sjelljes së tyre.
6. Më tutje ka deklaruar se pretendimet e Paditësit për shkelje të nenit 84 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe nenit 92 pika c me vendim të goditur janë të pabazuara dhe si të tilla jo relevante për atë, por edhe për gjykatën, ndërsa, objekti i inspektimit ishte monitorimi i tregut në sektorin e derivateve të naftës dhe benzinës. Ka theksuar se, pretendimet se në vendimin e goditur është nxjerrë një konstatim i përgjithësuar duke i përfshirë në këtë vendim të gjitha ndërmarrjet është i pasaktë dhe gjykatën e vë në lajthitje, ndërsa listimi i palëve në procedurë ka të bëjë me transparencën dhe duke respektuar neni 6 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit dhe neni 7 Parimi i objektivitetit dhe paanësisë sipas Ligjit Nr. 05/L-031.
7. Përveç kësaj, ka deklaruar se nga deklarata e z. B.M. zbulohet se informacioni i marre për çmimet nga klientit, kemi të bëjmë me një praktike të bashkërenduar që realizohet me kontakte të drejtpërdrejta ose të tërthorta midis firmave, synimi apo rezultati i të

cilave është që ndikohet sjellja në treg ose tu jepet informacion konkurrenteve në lidhje me veprimet e ardhshme. Përmendja e klientëve në deklaratë, në nuk e dimë kush janë ata klientë, çfarë profesione kanë apo janë menaxhere të kompanive tjera konkurren të naftës, të cilët në bisedë e sipër gjatë furnizimit me derivate të naftës, benzine, shkëmbejnë informacione në lidhje me çmimet e derivateve të naftës dhe benzinës. Sipas tij, në tregje të tilla, sjellja racionale dhe e pavarur e ndërmarrjeve mund të shpie në sjellje paralele pa hyrë në bashkëpunim, si dhe se ky fenomen shpesh referohet nga ekonomistët si "bashkëpunim i fshehtë i heshtur" ose "paralelizmi i ndërgjegjshëm". Nga këto veprime, sjellje konstatojmë se kjo praktikë është e bashkërenduar, rrjedhimisht e kualifikon si marrëveshje të heshtur, gjë që ka çrregulluar konkurrencën tregtare duke kryer shkelje nga nenin 4 para. 1 nënpara. 1 i LMK-së.

8. Më tutje ka shtuar se, Padiës në padinë e tij nuk ka paraqitur, bashkangjitur ndonjë tabelë, grafik, llogaritje tjetër matematikisht të saktë, statistika, për të sfiduar punën e Sekretariatit të Autoritetit, përkatësisht Departamentit për Mbikëqyrje të Tregut dhe vendimin e goditur.
9. Përveç kësaj, ka deklaruar se meqenëse periudha e shkeljes së këtij ligji është më e shkurtër se 6 muaj, ai e konsideron, si gjysmë viti dhe ndëshkimi aplikohet në qarkullimin për periudhën korrik-dhjetor 2018, në përputhje me neni 4. para. 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative.
10. Përfundimisht në përgjigje në padi ka deklaruar se, sjellja e ndërmarrjeve në treg është ndikuar si rezultat i një "bashkëpunimi të heshtur", ndërsa sjellja e bashkërenduar e konkurrentëve në lidhje me çmimet ka ndodhur heshturazi në formë të tërthortë në mes tyre, duke ndikuar në përcaktimin e çmimit dhe kushteve tjera tregtare me qëllimin e vetëm për të maksimizuar profitin e tyre në dëm të qytetarëve të Kosovës, gjë që për atë do të konsiderohet si interes publik. Sipas tij, ai i është referuar edhe praktikave në pajtim me Direktivat e Bashkimit Evropian për konkurrencën, sipas nenit 66 të Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
11. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, nuk qëndron pretendimi i Padiësit se ky vendim është nxjerrë me shkelje të dispozitave të LPPA-së për shkak se vendimi goditur është në përputhje të plotë me nenin 46, 47, 48 të LPPA-së. Sipas tij, ai ka konstatuar me vendimin e goditur se Padiësi e ka shkelur Ligjin për Mbrojtjen e

Konkurrencës për shkak se i njëjti ka hyrë në marrëveshje të ndaluar dhe praktikë të bashkërenduar me kompani të tjera, të cilat operojnë në tregun relevant në shitje me pakicë dhe shumicë të derivateve të naftës dhe benzinës. Në lidhje me këtë ka sqaruar se, këtë e vërteton dhe forma e caktimit të çmimit apo mazha e fitimit për muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, gjatë së cilës përkundër uljeve në bursës të gjitha kompanitë kishin shumëfishuar fitimin e tyre, në mesin e të cilave edhe Paditësi. Në vazhdim ka pohuar se, deri te ky vendim ka ardhur pas një sërë analizash nga ekspertët e saj, monitorimi i tregut dhe lëvizjet e këtyre çmimeve, prandaj gjatë procedurës hetimore provat i ka kërkuar nga vetë Paditësi të cilat i janë siguruar dhe mbi bazën e të cilave është vlerësuar ky rast dhe është shqiptuar masa administrative. Për fund ka shtuar se, vet fakti që Paditësi dhe subjektet tjera të shitjes së karburanteve gjatë kësaj periudhe e kanë rritur mazhën e fitimit, ndërsa në burës çmimi i karburanteve ka pësuar rënie, atëherë kjo nënkupton që Paditësi ka pasur marrëveshje të bashkërenduar me subjektet tjera për shitjen e karburanteve për caktimin e çmimit të shitjes së naftës dhe benzinës.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

12. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e provave. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: konkluzioni me nr.01/19 të datës 15.02.2019 i të paditurit; njoftimi i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë në emër të paditësit, me nr. 364/19 i datës 21.11.2019 i të paditurit; ankesa e paditësit kundër njoftimit me nr. . 364/19 i datës 21.11.2019 i të paditurit; njoftimi për konstatimin e gjendjes faktike në emër të paditësit, nr. 40/20 i datës 31.01.2020 i të paditurit; vendimi nr. 37/2020 i datës 06.05.2020 i të paditurit, si dhe shkresat e lëndës së procedurës administrative, të cilat i Padituri i ka dorëzuar me përgjigjen në padi, në bazë të nenit 37.3 i lidhur me nenin 43.1 të LKA-së.
13. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
14. I Padituri më 15.02.2019 përmes konkluzionit nr. 01/19 e kishte filluar procedurën hetimore administrative ndaj 16 shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe Paditësin, për shkak të dyshimit për çrregullim të konkurrencës në tregun e derivateve të naftës, në

kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 11 të LMK-së. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes konkluzionit të cekur në këtë paragraf.

15. Me të njëjtin konkluzion kishte kërkuara nga shoqëritë tregtare të përfshira në pikën I. të tij që në afatin prej 30 ditëve t'ia dërgoj librat e blerjes nga data 01.01.2018 deri 31.12.2018; librat e shitjes nga data 01.01.2018 deri 31.12.2018; kontratat dhe aneks kontratat e tenderëve të fituar prej datës 01.01.2018 deri 31.12.2018; marrëveshjet ose kontratat e bashkëpunimit me kompanitë tjera në shitblerjen e derivateve të naftës; çmimin ditor (blerës dhe shitës) të naftës dhe benzinës për periudhën kohore nga data 01.01.2018 deri 31.12.2018, si dhe të dhëna tjera që mund të kërkoreshin nga hetuesit e të Paditurit.
16. Grupi i inspektimit i të Paditurit më 18.07.2019 kishte vizituar Paditësin në fshatin Preoc të Graçanicës. Gjatë këtij inspektimi grupi i inspektimit i kishte parashtruar pyetje përfaqësuesit të Paditësit lidhur me caktimin e çmimit, marzhën e fitimi, bashkëpunimin me konkurrentët, qëndrimin e tij për një rregullator të naftëtarëve etj. Këto fakte vërtetohen nga procesverbali i sapo cekur, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
17. Më 20.12.2019 Paditësi i kishte dërguar komentet e tij lidhur me njoftimin për fakteve paraprake të konstatuar në procedurë. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit të goditur, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë parashtrësë e tillë.
18. Më 21.11.2019 Departamenti për Mbikëqyrjen e Tregut nëpërmjet Sekretariatit të së Paditurit kishte paraqitur njoftimin me numër të protokollit 364/19 të fakteve paraprake të konstatuara në procedurë për Paditësin, ndaj të cilit ky i fundit më 12.12.2019 kishte paraqitur ankesë. Gjykata e vërtetoi këtë fakt duke u mbështetur në njoftimin e paraqitur në këtë paragraf.
19. I Padituri përmes Departamentit për Mbikëqyrjen e Tregut më 31.01.2020 kishte paraqitur njoftimin nr. 40/20 për konstatimin e gjendjes faktike për Paditësin, përmes të cilit kishte konstatuar se Paditësi në tregun përkatës e ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, rrjedhimisht e ka shkelur nenin 4 para. 1 nënpara. 1 e LMK-së, meqë Paditësi në mënyrë të bashkërenduar me ndërmarrjet tjera kanë caktuar çmimin e shitjes me pakicë të produktit naftë dhe benzinë për periudhën kohore të muajve nëntor dhe dhjetor 2018. Përmes njoftimit të përmendur në këtë paragraf, gjykata e konstatoi këtë fakt.

20. I Padituri më 13.02.2020 kishte mbajtur seancën dëgjimore, gjatë të cilës përfaqësuesit e Paditësit kishin marrë pjesë dhe verbalisht i janë përgjigjur pyetjeve të komisionit të së Paditurit. Ky fakt rezulton nga transkriptim i procesverbalit, i nxjerrë nga audio incizimi i seancës dëgjimore, i datës 13.02.2020.
21. Më 06.05.2020 i Padituri e kishte dhënë vendimin nr. 37/2020, me të cilin (i) kishte konstatuar se Paditësi e ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2018, rrjedhimisht ka kryer shkelje të nenit 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, (ii) Paditësit i ka shqiptuar ndëshkim administrativ në shumë prej 3% të totalit të të hyrave për gjashtë muajt e vitit 2018, konkretisht shumën në vlerë prej 55,175.98€, (iii) ka konstatuar se Paditësi nuk e ka abuzuar pozitën dominuese në tregun individual ose kolektiv, përkatësisht nuk ka bërë shkelje të nenit 11 të LMK-së, (iv) e ka urdhëruar Paditësin që të ndaloj çdo veprim të mëtutjeshëm sikur në pikën I. të vendimit që ka të bëjë me vendosjen e çmimeve në mënyrë të bashkërenduar ose të heshtur me ndërmarrjet tjera dhe çdo veprim tjetër që e çrregullon konkurrencën, si dhe (v) ka caktuar se vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.
22. I Padituri në arsyetimin e vendimit të goditur fillimisht kishte sqaruar se procedurën hetimore e ka filluar me vetinativë, duke u bazuar në opinion e gjithmbarshëm dhe mediave, si dhe se për kundër faktit se çmimi i naftës ka pësuar rënien në bursë, megjithatë rënia nuk është reflektuar te shoqëritë tregtare që merren me shitblerjen e karburanteve. Gjithashtu, e ka sqaruar rrjedhën e procedurës administrative, duke cekur palët e përfshira, konkretisht Paditësin dhe 15 subjekte tjera të përfshira në hetimin në procedurën administrative. Si treg relevant e ka përcaktuar komplet territorin e Republikës së Kosovës.
23. Në arsyetimin e vendimit të goditur, i Padituri ka sqaruar se Paditësi ka importuar 15 herë gjatë vitit 2018 (15 importe benzinë apo 173,642:00 litra dhe 0 importe naftë apo 0.00 litra), që së bashku japin sasinë 173,642.00 litra, për të cila importe nuk ka paguar akcizë, kurse gjatë të njëjtit vit ka importuar 64,707,055.00 litra naftë dhe 1,724,788.00 litra benzine dhe që në total janë 66,431,843.00 litra derivate për vitin 2018. Në arsyetim gjithashtu ka sqaruar se pjesëmarrja e përgjithshme e Paditësit në tregun e naftës dhe benzinës është 10.37%, pjesëmarrja e përgjithshme në treg vetëm për naftë është 11.48%, ndërsa pjesëmarrja e përgjithshme në treg vetëm për benzinë është 2.25%.

24. Gjithashtu, i Padituri në vendimin e goditur ka sqaruar se ai është bazuar në nenin 66 të LMK-së dhe punimin “Ekonomia dhe Marrëveshjet e Heshtura” (anglisht: *The Economics of Tacit Collusion*), i përgatitur për “DG Competition”, nga i cili e ka nxjerr kuptimin për marrëveshjet e heshtura.
25. Në arsyetim të vendimit të goditur gjithashtu ka shprehur qëndrimin që nëpërmjet analizave ekonomike dhe statistikore e ka provuar se ka pasur marrëveshje të bashkërenduar, rrjedhimisht marrëveshje të heshtur ndërmjet shoqërive tregtare në procedurë.
26. Në këtë drejtim, për produktin naftë ka sqaruar se, gjatë analizës dhe përpunimit të të dhënave ka vërejtur se nga muaji janar i vitit 2018 deri tetor 2018 çmimi i blerës për litër ishte 0.93€, kurse çmimi shitës për litër ishte 1.01€, që nënkupton se fitimi bruto/litër ishte 0,09€, gjë që është reflektuese me çmimin e bursës botërore. Më tutje kishte sqaruar se, për muajin dhjetor të vitit 2018 çmimi i bursës kishte rënie nga muaji paraprak dhe po ashtu çmimi importues për litër ishte përafërsisht i njëjtë me muajin shkurt të vitit 2018, gjegjësisht 0.94 € për litër, ndërsa çmimi i shitjes ishte 1.11€ për litër, rrjedhimisht fitimi bruto për litër për muajin dhjetor ishte 0.17€, prandaj Paditësi nuk ka reflektuar me ulje të fitimit bruto për litër karshi uljes së çmimit të bursës dhe çmimit importues. Mbi këtë bazë ligjore dhe faktike, i Padituri kishte vlerësuar se Paditësi e ka caktuar çmimin shitjes dhe marzhën e fitimit bruto/litër për majtin nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, në mënyrë të bashkërenduar me ndërmarrjet tjera të cilat operojnë në tregun relevant, në shitje me pakicë, si formë e bashkëpunimit e cila sanksionohet me LMK. Sipas të Paditurit, shoqëritë tregtare të citat operojnë në tregun relevant (shitje me pakice) nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për litër në muajin nëntor dhe dhjetor, rrjedhimisht ato kanë pasur fitimin bruto për litër përafërsisht 9% për muajt janar deri tetor 2018, ndërsa për muajin nëntor 2018 në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto për litër mesatarisht 60% dhe për muajin nëntor 2018 kanë realizuar 124% më shumë fitim në raport me periudhën janar deri tetor 2018.
27. Ngjashëm, edhe për produktin benzinë ka sqaruar se, nga muaji janar 2018 deri tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto për litër ka qenë 0.13€ për litër, ndërsa për muajin nëntor 2018 dhe dhjetor 2018 mesatarja e fitimit bruto për litër ishte 0.27€. Në lidhje me këtë ka sqaruar se për muajin shkurt 2018 çmimi blerjes për litër ishte 0.92€, ndërsa fitimi bruto për litër ishte 0.13€, gjë që është reflektuese me çmimin e bursës botërore, ndërsa

për muajin dhjetor 2018, gjatë të cilit çmimi i bursës, po ashtu edhe çmimi importues, ishte më i ultë se muajt paraprak, gjegjësisht 0.87€ për litër, fitimi bruto për litër gjatë muajit dhjetor ishte 0.28€ për litër, që nënkupton se Paditësi nuk ka reflektuar me ulje të fitimit bruto për litër karshi uljes së çmimit të bursës dhe çmimit importues. Mbi këtë bazë ligjore dhe faktike, i Padituri kishte vlerësuar se Paditësi e ka caktuar çmimin shitjes dhe marzhën e fitimit bruto për muajin nëntor dhe dhjetor 2018, në mënyrë të bashkërenduar me shoqëritë tjetra tregtare të cilat operojnë në tregun relevant. Sipas të Paditurit, shoqëritë tregtare që janë subjekt i hetimit konkret dhe operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë për benzinë) nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për litër gjatë muajve nëntor dhe dhjetor, që nënkupton se ato kanë pasur fitimin bruto për litër përafërsisht 12% për muajt janar deri tetor 2018, ndërsa për muajin nëntor 2018 në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto për litër mesatarisht 108% dhe për muajin dhjetor 135% ne raport me periudhën janar deri tetor.

28. Më tutje, ka arsyetuar se forma e caktimit të çmimit apo të marzhës në praktikë të bashkërenduar nga ndërmarrjet cilat operojnë në tregun relevant, është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1. 1 LMK-së.
29. Për fund, i Padituri në arsyetimin e vendimit të goditur ka shpjeguar mënyrën e llogaritjes së sanksionit administrativ. Sipas tij, ai është mbështetur në nenin 56 para.1 nënpara. 1.1 dhe nenin 59 para. 2 dhe 4 të LMK-së, si dhe në nenet 3, 4 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2018 mbi Kriteret për Shqiptimin e Masës së Sanksioneve Administrative (këtu e tutje UA). Në këtë drejtim, ka qartësuar se, meqenëse periudha e shkelës së LMK-së është me e shkurtër se gjashtë muaj, atëherë si gjysmë viti duhet të trajtohet periudha kohore korrik deri dhjetor 2018, në përputhje me nenin 4 par. 4 te UA-së, rrjedhimisht edhe ndëshkimi duhet të llogaritet për këtë periudhë.
30. I Paditur i ka sqaruar se qarkullimi vjetor i Paditësit ishte 2,170,249.02€, nga e cila e ka zbritur TVSh-në prej 15.254%, rrjedhimisht fitimin neto e ka llogaritur në 1.898.199.23€, të cilin e ka trajtuar si bazë ndëshkimore. Nga kjo bazë e ka llogaritur 3%, që ka rezultuar me shumën prej 55,175.98€.

31. Përfundimisht, i Padituri ka arsyetuar se si një rrethanë lehtësuese e ka vlerësuar faktin se palët kanë bashkëpunuar me atë gjatë procedurave dhe se asnjë palë nuk ishte ndëshkuar më parë për ndonjë formë të çrregullimit të konkurrencës.
32. Përveç kësaj, gjykata gjithashtu vëren se i Padituri në vendimin e goditur nuk ka paraqitur të dhëna lidhur me sjelljen subjekteve tjera të hetuara në procedurën administrative, çmimet e shitjes me pakicë të naftës ose benzinës, e as marzhën e fitimit neto ose bruto të subjekteve tjera të hetuara në procedurën administrative.

III. Vlerësimi meritor i rastit

33. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e bazuar në ligj në raport me pikën I., II., IV., dhe V. të vendimit 37/2020 të datës 06.05.2020 të së Paditurit, rrjedhimisht akti administrativ i goditur duhet të anulohet në ato pjesë dhe çështja administrative duhet të zgjidhet vet nga gjykata.
34. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat e veçanta procedurale të LMK-së. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47 dhe 48 LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padituri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrativ dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.
35. Megjithatë, gjykata gjen se i Padituri në bazë të materialit provues që ka pasur në dispozicion në procedurën administrative, ka ardhur deri te përfundimet e gabuara të gjendjes faktike, si rezultat i të cilave e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se i Padituri kishte ardhur në përfundim se Paditësi së bashku me 15 shoqëri tregtare tjera të hetuara në procedurën administrative që merren me tregtinë e karburanteve në Kosovë kanë pasur marrëveshje të ndaluar, gjegjësisht ka pasur praktikë të bashkërenduar në caktimin e çmimeve.
36. Meqenëse shkelja konsiderohet të ketë ndodhur në muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, gjatë të cilëve ligj i zbatueshëm ka qenë Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (2010), i ndryshuar me Ligjin 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin

e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (2014), atëherë gjykata të gjitha vlerësimet juridike dhe faktike i ka bërë në bazë të dispozitave të këtyre ligjeve.

37. Neni 4 i LMK-së ka rregulluar si në vijim:

Neni 4

Marrëveshjet e ndaluara

1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave të ndërrmarjeve dhe praktikat e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që:

1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;

(...)

38. Nga përcaktimi ligjor i më sipërm, rrjedh se ka shkelje të nenit të cituar më lart nëse (i) ndërmjet shoqërive tregtare ekziston një marrëveshje, vendim ose praktikë e bashkërenduar, dhe (ii) ato shoqëri tregtare përmes asaj marrëveshjeje, vendimit ose bashkërendimit caktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çmimin e blerjes, shitjes ose ndonjë kusht tjetër të tregtimit në tregun relevant. Këto kritere duhet të plotësohen bashkërisht, pra të dytë në të njëjtën kohë.

39. Në rastin konkret, duke u bazuar në dispozitën e nenit 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, për shkeljen e të cilit i Padituri e ka gjete përgjegjës Paditësin, objekt i shqyrtimit gjatë procedurës administrative ka qenë vërtetimin i faktit se Paditësi a ka pasur praktikë të bashkërenduar me shoqëritë tregtare tjera të hetuara në procedurën administrative, lidhur me përcaktimin e drejtpërdrejtë ose tërthortë të çmimeve të shitjes së naftës dhe benzinës. Meqenëse i Padituri kishte ardhur në përfundim se Paditësi me shoqëritë tjera tregtare ka pasur “praktikë të bashkërenduar”, atëherë gjykata do shtjelloj plotësimin e kushtit të parë vetëm në drejtim të kësaj gjetjes.

40. LMK në nenin 3 para. 1 nënpara. 2 ka përkufizuar se “*Praktika e Bashkërenduar - një aktivitet që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal në mes të dy ose më shumë ndërmarrjeve dhe që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale*”. Siç vërehet

nga ky definicion, për të ekzistuar “praktika e bashkërenduar” nuk është e nevojshme që ndërmjet palëve të ketë ndonjë marrëveshje ose vendim formal lidhur me bashkëpunimin e tyre, por është e mjaftueshme që të ketë një aktivitet bashkëpunimi joformal ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve.

41. Në lidhje me këtë, gjykata vlerëson se në bazë të provave në shkresat e lëndës në procedurën administrative të i Padituri, nuk është vërtetuar se Paditësi ka pasur praktikë të bashkërenduar me subjektet tjera të hetuara në procedurën administrative. I Padituri në vendimin e goditur nuk ka sqaruar se në çfarë forme është manifestuar bashkëpunimi i Paditësit me subjektet tjera në procedurë, gjegjësisht cili ka qenë aktiviteti lidhur me bashkëpunimin jo formal. Megjithatë, gjykata në bazë të vendimit të goditur, përgjigjes në padi të së Paditurit, shkresave të lëndës administrative dhe argumenteve të së Paditurit gjatë procedurës së konfliktit administrativ në këtë gjykatë, vëren se i Padituri qëndrimin e tij se Paditësi e ka pasur praktikë të bashkërenduar me subjektet tjera të hetuara në procedurën administrative e bazon në marzhën e fitimit neto që e ka konstatuar për Paditësin për muajt nëntor dhe dhjetor të viti 2018 në krahasim me muajt paraprak, e cila sipas të Paditurit ka ardhur si rezultat i mos reflektimit të Paditësit dhe subjekteve tjera në procedurën administrative ndaj uljes së çmimeve në bursën ndërkombëtare. Në këtë drejtim, gjykata në rend të parë gjen se, nga arsyetimi vendimit të goditur nuk rezulton sjellja e shoqërive tjera tregtare të hetuara në procedurën administrative, por vetëm e Paditësit. Pra, gjykata në bazë të aktit administrativ të goditur nuk arrin të kuptoj se sjellja e Paditësit në shitjen naftës dhe benzinës a ka qenë e njëjtësuar me sjelljen e subjekteve tjera në procedurën administrative, meqenëse në arsyetimin e vendimit të goditur mungojnë të dhënat për sjelljet subjekteve tjera në procedurën administrative. Kështu, nga arsyetimi i aktit administrativ është e pamundshme të kuptohet sjellja e subjekteve të tjera në procedurën administrative, me qëllim që veprimet tyre të krahasohen me sjelljen e Paditësit. Konkretisht nuk dihet se a e kanë ulur apo jo çmimin e shitjes së naftës dhe benzinës subjektet tjera të hetuara në procedurën administrative kur ka pas rënie të çmimit me shumicë të karburanteve (çmimi blerës) dhe ato subjekte a e kanë pasur të njëjtën marzhë të fitimit bruto ose neto sikur Paditësi, rrjedhimisht nuk mund të kuptohet se veprimet e Paditësit dhe subjekteve tjera në procedurën a paraqesin bashkëpunim. Për këtë gjykatë, pa këto të dhëna është e pamundshme të konstatohet se çmimet e naftës dhe benzinës, të cilat i ka

pasur Paditësit gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2018 kanë qenë të caktuara në bashkëpunim jo formal me subjektet tjera në procedurë.

42. Në anën tjetër, fakti se Paditësi dhe subjektet tjera në procedurën administrative janë takuar në mbledhjet e Shoqatës së Naftëtarëve nuk përbën bazë të mjaftueshme për të ardhur në përfundimin se ka pasur bashkëpunim ndërmjet Paditësit dhe anëtarëve tjerë të asaj shoqate, në veçanti me subjektet tjera në procedurën administrative. Themelimi dhe pjesëmarrja në organizata të tilla përveç që është e ligjshme është edhe garanci kushtetuese nga neni 44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rrjedhimisht nuk mund të interpretohet si bashkëpunim mes subjekteve në procedurë me qëllim që të përcaktojnë çmimet në tregun përkatës, përderisa nuk dëshmohet qartazi se ato takime kanë pasur për qëllim bashkëpunimin për caktimin e çmimeve në mënyrë të bashkërenduar.
43. Për këto arsye, gjykata gjen se në bazë të provave në procedurën administrative nuk është vërtetuar se Paditësi ka pasur bashkëpunim joformal që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale me subjektet tjera në procedurë administrative, pra nuk është vërtetuar se Paditësi ka pasur praktikë të bashkërenduar me subjektet tjera në procedurën administrative, rrjedhimisht nuk plotësohet kushti i parë i cekur më lart.
44. Lidhur me kriterin e dytë, konkretisht që shoqëritë tregtare përmes asaj marrëveshjeje, vendimit ose bashkërendimit të caktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çmimin e blerjes, shitjes ose ndonjë kusht tjetër të tregtimit në tregun relevant, gjykata gjen se, në vendimin e goditur nuk është paraqitur asnjë analizë se në çfarë forme Paditësi dhe subjektet tjera të hetuara në procedurë administrative në mënyrë të bashkërenduar kanë tentuar ose i kanë caktuar e çmimet e shitjes së naftës dhe benzinës në tregun relevant.
45. Në rend të parë, në vendimin e goditur janë paraqitur çmimet e shitjes së naftës dhe benzinës së Paditësit, por mungojnë të dhënat për çmimet dhe marzhën e fitimit për subjekteve tjera të hetuara në procedurën administrative. Për pasoj nuk mund të kuptohet cili ka qenë çmimi, me të cilin subjektet tjera në procedurën administrative gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018 e kanë shitur me pakicë naftën dhe benzinën, ashtu që të krahasohet ngjashmëria e çmimeve të tyre me Paditësin. Ngjashëm, për shkak të mungesës së të dhënave, nuk është e mundshme të kuptohet marzha e fitimit e subjekteve tjera të hetuara në procedurën administrative, rrjedhimisht nuk mund të vërehet se a është caktuar në mënyrë të indirekte çmimi i shitjes me pakicë

i naftës dhe benzinës përmes përcaktimit të marzhës së fitimit. Pra, edhe në këtë rast gjykata në bazë të vendimit të goditur e pati të pamundshme vërej njëjtësim e çmimeve ose marzhës së fitimit mes Paditësit dhe subjekteve tjera në procedurën administrative.

46. Lidhur me marzhën e fitimit, si formë e tërthortë e caktimit të çmimit dhe bazë për konstatimin e shkeljeve të nenit 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, gjykata sqaron se lartësia e fitimit bruto ose neto nuk është përcaktues në konstatimin e shkeljes së dispozitës së sapo cekur, përderisa nuk vërtetohet se (i) Paditësi dhe subjektet tjera në procedurë kanë marzhë të ngjashme të fitimit, dhe (ii) çmimi i shitjes është përcaktuar duke caktuar lartësinë e marzhës së fitimit.
47. Për vërtetimin e të gjitha çështjeve relevante lidhur me konstatimin e shkeljeve nga neni 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, për të cilën i Padituri mund të shqiptoj ndëshkime në të holla, barra e provës i takon të Paditurit. Edhe pse LMK në asnjë dispozitë të tij nuk e ka rregulluar barrën e provës, megjithatë duke u bazuar në nenet 74 dhe 75 të Marrëveshjes për Stabilizim Asociimin (këtu e tutje MSA) të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Republika e Kosovës e merr për obligim që ta përafroj legjislacionin e saj me *acquis*-in e BE-së dhe çdo praktikë që është në kundërshtim me neni 75 të MSA-së ta vlerësoj në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të aplikueshme të konkurrencës në BE, në veçanti nga nenet 101, 102, 106 dhe 107 të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe instrumentet interpretuese të miratuara nga institucionet e BE-së (shih nenit 75 para. 2 i MSA-së). Përveç kësaj, edhe vet neni 66 i LMK-së kërkon që zbatimi i atij ligji duhet të jetë në pajtim me Direktivat e Bashkimit Evropian për konkurrencën. Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se dispozitat e Rregullores (KE) nr. 1/2003 të Këshillit Evropian të datës 16 dhjetor 2002 për Zbatimin e Rregullave të Konkurrencës, si pjesë përbërëse e së drejtës së BE-së lidhur me çështjet nga fusha e konkurrencës, duhet të zbatohet në këtë rast.
48. Sipas nenit 2 të rregullores së cekur në pasuesin e mësipërm “*Në të gjitha procedurat kombëtare dhe të komunitetit për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të Traktatit, barra e provës për një shkelje të nenit 81, paragrafi 1 ose nenit 82 të Traktatit i takon palës ose autoritetit që bën këtë akuzë. Barra e provës për faktin se plotësohen kushtet e nenit 81, paragrafi 3 të Traktatit, i takon ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve që i referohen këtij dispozicioni*”. Nga kjo rrjedhë se, barra e provës për të provuar se një shoqëri tregtare ka vepruar në kundërshtim me dispozitat që e rregullojnë konkurrencën, në rastin konkret nenit 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, për të cilat mund

të shqiptohet gjobë ndëshkuese, i takojnë autoritetit publik që pretendon se ajo shkelje ka ndodhur, në rastin konkret të Paditurit.

49. Madje siç rrjedh nga praktika e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (këtu e tutje GjDBE), në këtë rast, zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë, i cili është një parim i përgjithshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian dhe që është përfshirë në nenin 48 para. 1 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (shih vendimin e datës 22 nëntor 2012, E.ON Energie kundër Komisioni, C-89/11 P, EU:C:2012:738, pika 72 e tutje dhe jurisprudencën e përmendur aty). Ky parim, sipas jurisprudencës së GjDBE-së, është i zbatueshëm në procedurat për shkelje të rregullave të konkurrencës që vlejnë për ndërmarrjet dhe që mund të çojnë në vendosjen e gjobave apo gjobave ndëshkuese (shih vendimin e datës 22 nëntor 2012, E.ON Energie kundër Komisioni, C-89/11 P, EU:C:2012:738, pika 73 dhe jurisprudencën e përmendur aty).
50. Pra, juridikisht është obligim i të Paditurit që në procedurën administrative të vërtetoj se Paditësi me subjektet tjera të hetuara në të njëjtën procedurë administrative e ka pasur aktivitet në bazë të bashkëpunim joformal, përmes të cilit kanë caktuar ose ka tentuar të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi në tregun naftës dhe benzinës, meqenëse për këto shkelje i Padituri ligjërisht është i autorizuar të shqiptoj gjoba ndëshkuese.
51. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, në këtë gjykatë janë zhvilluar dhe në momentin e dhënies së këtij aktgjykimi janë në zhvillim edhe lëndë tjera të ngjashme ndërmjet të Paditurit dhe subjekteve tjera të hetuara në të njëjtën procedurë administrative, megjithatë gjykata e ka juridikisht të pamundshme që njohurit e marra nga një lëndë e caktuar lidhur me sjelljen e subjekteve tjera të hetuara në procedurën administrative t'i bartë në lëndën tjetër (në këtë lëndë), meqenëse ato janë lëndë të veçanta (të ndara) bazuar në padi të veçanta, si dhe kundër akteve administrative të veçanta. Kjo edhe për faktin se, Paditësit do ta kishte të pamundshme që të deklarohet ose të paraqes kundërshtime në raport me faktet e paraqitura dhe provat e administruara në procedurat tjera. Përveç kësaj, gjykata nuk e pati juridikisht të mundshme t'i bashkoj lëndët, meqenëse për këtë gjë nuk e kishte pëlqimin e palëve, siç kërkon nenit 408 para. 3 i LPK-së.
52. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pajtohet me sqarimet dhe definicionet juridike të së Paditurit të dhëna në vendimin e goditur dhe gjatë procedurës para kësaj

gjykate, megjithatë thelbi i anulimit të aktit administrativ të së Paditurit qëndron në faktin se rrethanat, nga të cilat varet konstatimi i shkeljeve të nenit 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, nuk janë paraqitur në vendimin e goditur, rrjedhimisht për këtë gjykatë nuk janë vërtetuar në procedurën administrative para të Paditurit.

53. Konstatimet e gabuar të gjendjes faktike të bëra nga i Padituri kanë rezultuar me zbatim të gabuar të së drejtës materiale administrative lidhur me shqiptimin e ndëshkimeve administrative. Shqiptimi i gjobave ndëshkuese është e rregulluar me nenin 56 para. 1 nënpara. 1 [Masat Ndëshkuese për Shkelje të Rënda të Rregullave në Konkurrencën e Tregut] të LMK-së, sipas të cilit *“1. Masa ndëshkuese në një shumë deri në dhjetë përqind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja e ka realizuar në vitin e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, ndëshkohet ndërmarrja nëse: 1.1. lidhë marrëveshje të ndaluar ose në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë në marrëveshjen me të cilën është çrregulluar konkurrenca, në mënyrën e përshkruar në dispozitën e nenit 4 të këtij ligji”*. Siç vërehet nga dispozita e sapo cituar, kusht për shqiptimin e masës ndëshkuese është lidhja e marrëveshjes së ndaluar, me të cilën çrregullohet konkurrenca në mënyrën e përshkruar në nenin 4 të LMK-së. Meqenëse në rastin konkret nuk është konstatuar se Paditësi e ka shkelur nenin 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së, atëherë nenin 56 dhe dispozitat pasuese lidhur me rrethanat në bazë të cilave përcaktohet lartësia e masës ndëshkimore nuk mund të zbatohen.
54. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata përfundimisht e gjeti se vendimi i goditur në pikën I., II., IV., dhe V. është dhënë duke u bazuar në gjendje të gabuar faktike, e cila ka çuar edhe në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale administrative. Këto shkelje janë në kundërshtim me nenin 4 para. 1 nënpara. 1 të LMK-së dhe nenit 51 para. 1 nënpara. 5 të LPPA-së lidhur me nenin 16 para. 1 nënpara. 3 të LKA-së, rrjedhimisht gjykata e anuloi atë në pikat I., II., IV., dhe V.
55. Gjithashtu gjykata vlerëson se natyra e konfliktit administrativ konkret është e atillë, që nuk është e nevojshme nxjerrja e aktit të ri administrativ, rrjedhimisht gjykata vendosi që vetë ta anuloj vendimin, pa e obliguar të Paditurën që të nxjerr akt tjetër administrativ. Fakti se i Padituri për secilin subjekt të hetuar në procedurën administrative ka dhënë vendim të veçantë me arsyetimin përkatës, të cilët kanë përfunduar me vendim gjyqësor ose janë në shqyrtim e sipër në këtë gjykatë, e bëri të pamundshme që lënda të kthehet në rivendosje te i Padituri, pasi ai vendim nuk mund të plotësohet për palët që e kanë përfunduar procedurën e konfliktit administrativ ose

janë të pritjet të vendimit gjyqësor në bazë të padisë së tyre. Gjykata vendosi se ky aktgjykim e zëvendëson aktin administrativ të anuluar, në bazë të nenit 46 para. 4 i LKA-së.

56. Gjykata rikujton se, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, siç parasheh neni 44 para. 1 i LKA-së, ndërsa për nulitetin (paligjshmërinë) e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA. Kjo nënkupton se, gjykata e shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur edhe për arsye të cilat paditësi nuk i nga ngritur para gjykatës.
57. Në anën tjetër, gjykata e vlerësoi padinë e Paditësit edhe në raport me kërkesën e Paditësit që të anulohet Njoftimi mbi Konstatimin e Gjendjes faktike nr. 40/20 i datës 31.01.2020 i të Paditurit dhe pika III. të dispozitivit të vendimit të goditur, dhe erdhi në përfundim se ajo është e palejuar në këto pjesë.
58. Sipas nenit 13 para. 1 të LKA-së “*Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë*”, ndërsa në para. 2 së të njëjtin nen përcaktohet se “*Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*”. Objektin e konflikti administrativ e ka rregulluar edhe neni 14 i LKA-së, sipas të cilit “*Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.*”
59. Siç vërehet nga dispozitat e neneve të cituar më lartë, objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ mund të jetë vetëm shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit administrativ përfundimtar të organit administrativ të shkallës së dytë ose të shkallës së parë në raste të caktuara, si dhe heshtja administrative.
60. Neni 3 para. 1.2 i LKA-së aktin administrativ e ka definuar se “*Akt administrativ - çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publik edhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative*”. Nga ky definicion ligjor vërehet se, për tu konsideruar një veprim procedural administrativ si akt administrativ në kuptim të LKA-së, ai duhet që (i) të

nxirret nga një organ administrativ në kuptim të nenit 3 para. 1 nënpara. 1.2 të LKA-së, (ii) të nxirret në fund të procedurës administrative në ushtrimin e autorizimeve publik, (iii) që në vendosjen e çështjes administrative t'i prek në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e palëve në procedurën administrative.

61. Në rastin konkret, Njoftimi mbi Konstatimin e Gjendjes faktike nr. 40/20 i datës 31.01.2020 i të Paditurit nuk është akt administrativ përfundimtar, por ai paraqet veprim procedural administrativ të obligueshëm për të Paditurin para seancës dëgjimore nga neni 49 para. 2 i LMK-së. Ky veprim procedural nuk ndërmerret në fund të procedurës administrative, pra me atë nuk përfundon procedura administrative. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.2 të LKA-së, sipas të cilit *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) 1.2. akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ;”*.
62. Lidhur me pikë III të vendimit të goditur, në këtë drejtim gjykata rikujton se me atë pikë ishte konstatuar se Paditësi nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në tregun individual ose kolektiv, përkatësisht nuk e ka shkelur nenin 11 të LMK-së. Siç vërehet, kjo pikë e vendimit të goditur është në favor të Paditësit, rrjedhimisht me të nuk cenohet as një e drejtë ose interes i tij, e as nuk ngarkohet me ndonjë detyrim. Gjykata gjithashtu vërejtë se Paditësi në asnjë moment gjatë procedurës nuk ka deklaruar se me padi nuk kërkohet shqyrtimi i ligjshmërisë lidhur me pikën III. të dispozitivit të vendimit të goditur.
63. Duke qenë kështu, gjykata vlerëson se Paditësi nuk ka të drejtë të kërkoj anulimin e një akti administrativ në pjesën, e cila nuk i cenon të drejtat e tij e as nuk i cakton atij ndonjë detyrim. Këtë qëndrim gjykata e mbështet në nenin 10 para. 1 të LKA-së, sipas të cilit *“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor”*, si dhe nenin 34 para. 1 nënpara. 3 të LKA-së, i cili ka përcaktuar se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj”*
64. Prandaj, duke qenë se Njoftimi për Konstatimin e Gjendjes Faktike nr. 40/2020 i datës 31.01.2020 i të Paditurit nuk është akt administrativ përfundimtar, si dhe pika III e

vendimit të goditur nuk i cenon të drejtat dhe interesat e Paditësit, atëherë gjykata në bazë të nenit 34 para. 1 nënpara. 2 dhe 3 të LKA-së e hodhi poshtë padinë lidhur me këtë pjesë.

65. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 para. 3 lidhur me nenin 46 para. 4 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.400/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.